

SHFMU “HASAN Z. KAMBERI” – SLLOVI

Shkolla “Hasan Z. Kamberi” në Sllovi është një ndër shkollat më të mëdha në komunën e Lipjanit, mësimet e para i filloi pas luftës së dytë botërore gjatë viteve 1945/46.

Mësuesi i parë në këtë shkollë ishte Demir Salihu-Gashi, në fillim mësohej në gjuhën Arabe, por shumë shpejt filluan të mësonin në gjuhën shqipe.

Mësimi mbahej kryesisht në Xhami të fshatit, ato vite shkolla kishte të regjistruar gjithsej 77 nxënës të moshave të ndryshme dhe të cilët ishin nga fshati Sllovi dhe Smallushë.

Demiri vazhdoi për tre vite ku mësues tjetër në fshat erdhi edhe Mehmet Reçica me bashkëshorten e tij Mejreme Reçica .

Qeveria e atëhershme pa asnjë arsye objektive mbylli klasën e pestë, ku mësimin këta nxënës u obliguan të vazhdonin në shkollën fillore të Gadimes në vitin shkollor 1952/53, kjo ishte gjenerata e parë e cila përfundoi klasën e tetë, dhe në mungesë të kuadrit ata u angazhuan në vende të ndryshme si mësues dhe nëpunës në administratën civile.

Në vitin shkollor 1953/54 përsëri u rihap klasa e pestë në gjuhën shqipe në të cilën drejtor u emërua Sherif Ahmeti hoxhë dhe intelektual i njohur edhe jashtë mjedisit komunal të Lipjanit.

Viti 1955/56 vit i aksionit të armëve i dhunës dhe torturës fizike shtetërore serbe ndaj shqiptarëve në Sllovi u rrahën, torturuan afro 40 shqiptar, po në të njëjtin vit komunistet konfirmojnë përcaktimin e tyre antishqiptar dhe me dekret shtetëror mbyllën klasat e larta të fillores me pretekstin se klasa e VI i kishte vetëm 16 nxënës, kurse me normat ligjore lejonte paralele minimumi 15 nxënës.

Në fund të vitit shkollor qeveria urdhëron përgjegjës-drejtorin Beqir Peqani që të mbyllet klasa e V dhe e VII me mësim në gjuhën shqipe.

Në vitin shkollor 1959/60 rihapen për herë të tretë paralelet e ciklit të lartë fillor, ku në vitin 1960 shkolla mëvetësohet nga shkolla serbe e Gushtericës së epërme dhe pas kaq viteve shkolla e Sllovisë bëhet shkollë e plotë tetëvjeçare ku drejtor i parë emërohet Ruzhdi Marevci .

Në vitin 1962 shkolla emërohet me emrin “Vllaznim Bashkim” me paralele të ndarë në Smallushë, kryen misionin e edukimit e arsimimit si shkollë e plotë tetëvjeçare.

Pas vitit 1966 në këtë shkollë erdhën një grup arsimtarësh Sllovia me koncept të avancuar kombëtar, ku me 1969 ky grup mësimdhënësish përplasit politikisht me qeverinë lokale, të cilën pushtetarët komunal e shfrytëzuan për arrestimin, dënimin dhe largimin e këtij grupi nga procesi mësimor i kësaj shkolle dhe pas vuajtjes së dënimeve i larguan edhe nga treva komunale e Lipjanit.

Shkolla fillore në Sllovi në dekadën e sundimit me mentalitet mesjetar sllav ortodoks me 1990/99 sikurse edhe gjithë sistemi shkollor shqiptar në Kosovë, përjetoi dhunën fizike dhe materiale, me veprime diskriminuese gjenocidale, bëri largimin e dhunshëm të nxënësve e arsimtarëve shqiptar nga objektet shkollore dhe ndërprerjen e financimit për të gjithë sistemin arsimor shqiptar në Kosovë.

Megjithatë, shkolla shqipe, si kudo edhe në Sllovi nuk i u nënshtrua robërisë së egër sllave, me një rezistencë të përgjithshme e të organizuar nisi rrugën e mëvetësisë, rrugën e ndarjes shpirtërore fizike e administrative qeverisëse nga sunduesi shekullor serb.

Gjatë këtyre viteve shkolla materializoi formën dhe përmbajtjen e veprimtarisë arsimore, mori emrin e ri “Hasan Zyko Kamberi”.

Gjatë viteve 1990/99 sukcesi në shkollën tonë nuk mungoi dhe nëpër garat të cilat mbaheshin gjatë këtyre viteve nxënësit e shkollës sonë arritën suksese të mëdha në shumë lëndë që organizoheshin në nivel të Republikës dhe nivel kombëtar.

Në lëndën e matematikës në garat republikane nxënësja Teutë Gërbeshi mori vendin e parë për klasat e shtata, ku pastaj mori pjesë edhe në nivel mbarëkombëtar ku garat mbaheshin në Gostivar dhe Kërçovë ku edhe atje mori vendin e katërt.

Por suksesin e saj e vazhduan edhe shumë nxënës të tjerë të cilët edhe në garat të lëndëve të tjera morën vendet e para si në lëndën e gjuhës shqipe, angleze, gjeografisë, historisë, fizikës dhe lëndëve tjera. Më të dalluarit ishin nxënësit :

- Ardian Salihu
- Vjollcë Kryeziu
- Agron Avdyli

- Shukrie Gërbeshi
- Ideal Rexha
- Shqipe Gërbeshi

E shumë të tjerë, ku për këtë sukses të arritur shkolla mori mirënjohje nga Ministria e Arsimit të Republikës së Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe shkolla kishte 522 nxënës.

Nga paslufta në qershor 1999 në rrethana të reja në sistemin tonë shkollor, përkundër pësimeve të mëdha të këtij lokaliteti, në të cilën forcat serbe vranë 45 qytetar shqiptar, nga të cilët edhe dy punëtor të kësaj shkolle, dhe plagosjen e 11 të tjerëve, nga të cilët edhe një arsimtar i kësaj shkolle. Ky vendbanim pësoi edhe shumë dëme materiale, kallje e plaçkitje të vlerave shpirtërore e materiale, si dhe shkatërrimin e inventarit, mjeteve mësimore, kabineteve dhe bibliotekën e shkollës.

Kjo shkollë në rrethana të reja në Kosovën e paslufte, rifilloi procesin edukativo-arsimor për disa vjet veproi shkollë tetëvjeçare, e më vonë me procesin integrues të reformave të reja demokratike, kaloi në nivele të shkollimit nëntëvjeçar në të cilën veprimtarinë arsimore e mbajnë 42 punëtor arsimi, e mësimet i vazhduan 719 nxënës shqiptar.

Edhe gjatë këtyre viteve sukseset e shkollës tonë nuk munguan si garat komunale ashtu edhe në testin e arritshmërisë të organizuar nga MASHT-i, shkolla tregoi rezultate të mira duke shënuar për çdo vit ngritje të rezultatit, duke u renditur në vendin e dytë në komunën e Lipjanit.

Në garat e organizuara nga shoqata “Gjuhëtari i ri” e të organizuara edhe në nivel komunal, nxënësja Gresa Neziri mori vendin e parë, kurse në nivel të Kosovës mori vendin e tetë.

Në garat e organizuara nga departamenti për kulturë, rini dhe sport në Lipjan nxënësit e shkollës sonë morën vendin e parë në futboll, po ashtu edhe në garat e organizuara nga Policia e Kosovës në çiklizëm nxënësi i shkollës sonë mori vendin e parë.

Në garën e organizuar nga DKA-ja në Lipjan për lëndën e Matematikës nxënësi i shkollës sonë mori vendin e pestë.

Pastaj sukseset vazhduan edhe në garat të cilat i organizoi kolegji “Mehmet Akif” për lëndën e kimisë në nivel të Kosovës nxënësit Durim Gashi dhe Afërdita Gashi morën medaljen e bronzit dhe të argjend.

Tani në shkollën tonë vijojnë mësimet 686 nxënës me 42 punëtor në dy objekte shkollore.

Kjo shkollë ka një strukturë të mirë gjinore, ku përfshirja e nxënësve të gjinisë femërore është pothuaj e barabartë me meshkuj, dhe kjo tregon se sistemi gjithëpërfshirës i arsimit ka arritur nivelin e duhur.

Po ashtu edhe struktura gjinore e stafit mësimdhënës është nga 35 gjithsej 21 prej tyre janë femra.

Tani në shkollën tonë mësimi zhvillohet në dy ndërrime, ka gjithsej 28 paralele, 15 paralele 1-5, 11 paralele 6-9 dhe dy Parafillor, me gjithsej 17 dhoma mësimi.

Sillovi

Drejtori i Shkollës

Qazim Salihu